



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:251600

Datë: 17.10.2024

Numri i dokumentit: 06313775

**Në çështjen juridike të :**

**AC-I-23-0692-A0001**

*Paditësi*

S S me përfaqësues sipas autorizimit, avokatin B I, Prishtinë

**Kundër:**

*E paditura/Ankuese*

N.SH. “Ingeniering”, (në likuidim), me përfaqësuese **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishte, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-5620, të datës 11 tetor 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 17 tetor 2024, lëshon këtë:

## A K T G J Y K I M

1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.
2. Vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-5620, i datës 11 tetor 2023.
3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

## **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë 19 qershor 2014, paditësi kishte paraqitur një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN129-0083 të datës 15 maj 2014, me të cilin vendim kërkesa e paditësit për kompensim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës në shumë prej 21,645.00 euro, ishte refuzuar si e pavlefshme, pasi që AL kishte vlerësuar se në bazë të nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar, kërkesa ishte parashkuar.

Paditësi në ankesë kishte theksuar se meqenëse kontrata e punës së punëtorëve nuk është ndërperë asnjëherë deri në momentin e privatizimit të N.SH-së atëherë këtyre punëtorëve pa përjashtim ju takon e drejta e dëmshpërblimit. Paditësi i kishte propozuar gjykatës që të anulohet vendimi i ankimuar i AL-së me nr. PRN129-0083 i datës 15 maj 2014, ndërsa të njëjtit t'i njihet e drejta në kompensim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënies së punës në shumë prej 1,351.35 euro. Ankesës i kishte bashkëngjitur: autorizimin për përfaqësim, kopjen e librezës së punës, vendimin e ankimuar të AL-së me nr. PRN129-0083 i datës 15 maj 2014, listën e punëtorëve dhe kalkulimin e padive, formularët e deklarimit të ATK-së si dhe një listë të pagave.

Me datë 8 shtator 2023, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në të cilën kishte theksuar se parashtruesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit për AKP-në është shkelur nga Autoriteti i Likuidimit në marrjen e vendimit dhe në këtë mënyrë kishte shkelur nenin 74.2 i Ligjit për DHPGJS i cili parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të Autoritetit të Likuidimit duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin për AKP-në. Pala kundërshtare kishte rikujtuar se natyra e lëndës është përsëritëse- pra ka një jurisprudencë të konfirmuar disa herë në DHPGJS e cila trajton këtë lloj pretendimi. Tutje pala kundërshtare gjithashtu shton se Ligji për AKP-në specifikisht parasheh parashkrimin e kërkesës si bazë për refuzim mirëpo dispozitat në fjalë janë të llojit blanket dhe referojnë në dispozitat e ligjeve të aplikueshme që në këtë rast është neni 608 i Ligjit mbi Punën e Bashkuar. Kërkesa e paditësit në këtë rast është e parashkuar pasi që nuk ka asnjë provë të paraqitur pranë ndonjë autoriteti para përfundimit të periudhës së parashkrimit. Andaj, e paditura i kishte propozuar gjykatës që të refuzohet ankesa e ankuesit si e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i AL-së si i bazuar. Mbrojtjes i kishte bashkëngjitur: vendimin e ankimuar të AL-së me nr. PRN129-0083 të datës 15 maj 2014.

Me datë 11 shtator 2023, gjykata kishte lëshuar një urdhër për paditësin nga i cili kishte kërkuar që të dorëzoj në gjykatë njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së tij si dhe prova shtesë në mbështetje të ankesës.

Me datë 22 shtator 2023, paditësi duke iu përgjigjur urdhrin të lartcekur të gjykatës kishte dorëzuar në DHPGJS: kopjen e librezës së punës, njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit të datës 14 janar 2009, listën me llogaritjen e të ardhurave personale për muajin dhjetor 2006 si dhe vendimin e ankimuar të AL-së me nr. PRN129-0083 të datës 15 maj 2014.

Me datë 11 tetor 2023, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-5620 kishte aprovuar si pjesërisht të bazuar ankesën e ankuesit dhe kishte ndryshuar vendimin e ankimuar të AL-së me nr. PRN129-0083 të datës 15 maj 2014, ashtu që kishte obliguar të paditurën që t'i paguaj ankuesit në emër të dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës shumë prej 1,168.00 euro si dhe në emër të interesit ligjor prej 10% shumë prej 116.00 euro. Gjithashtu gjykata e kishte obliguar të paditurën që ankuesit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 134.00 euro. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi ishte theksuar se gjykata e kishte aprovuar shumë si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi duke u bazuar në listën e pagave për muajin dhjetor 2006 ku ankuesi pagën e fundit e cila i ishte paguar ishte në shumë prej 292.00 euro, kurse nga librezat e punës ishte vërtetuar se ankuesi kishte ofruar shërbime pune për N.SH-në nga data 2 prill 1979 deri me 14 janar 2009 e që i bie se ka ofruar shërbime për 24 vite e 8 muaj. Andaj gjykata në bazë të dispozitave ligjore të lartcekura kishte ardhur në përfundim se ankuesit i takojnë 4 paga dhe shuma e pagës mujore ishte 292.00 euro, pra në total shuma prej 1,168.00 euro.

Me datë 17 nëntor 2023, e paditura (AKP) kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit C-IV-14-5620 të datës 11 tetor 2023, duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të ndryshoj Aktgjykimin e ankimuar dhe të vërtetoj vendimin e Autoritetit të Likuidimit. Në ankesë theksohet se gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra dhe atë se ekzistojnë dy afate të ndryshme të parashkrimit të cilat Autoriteti i Likuidimit e ka për obligim t'i pranoj dhe përmes të cilave Autoriteti i Likuidimit aplikon në mënyrë të drejtë ligjin. Afati i parë ka të bëjë me "Afatin për parashkrimin e kërkesave" që është afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedurë të likuidimit dhe afati i dytë që ka të bëjë me natyrën (meritat) e të drejtës të cilën parashtruesi ka kërkuar të zbatohet në kërkesë. Dy afatet e lartcekura janë të ndara dhe të dallueshme dhe një kreditor duhet t'i përmbushë të dy afatet në mënyrë të kërkesa e tij të pranohet. Andaj, Autoriteti i Likuidimit fton DHPGJS-në që të lëshohet

edhe njëherë në shqyrtim të çështjes në fjalë dhe të konsideroj argumentet e Autoritetit të Likuidimit që kanë të bëjnë me kufizimet e të drejtave të parashtruesve e që këto kufizime Autoriteti i Likuidimit është i obliguar që t'i zbatoj ex officio. Andaj, Kolegjit të Apelit i kishte propozuar si më lartë. Ankesës i kishte bashkëngjitur vendimin e Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 24 korrik 2024, paditësi kishte paraqitur përgjigje në ankesën e të paditurës në të cilën i propozon Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të refuzohet si e pabazuar ankesa e ankueses, ndërsa të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të detyrohet e paditura të bëj kompensimin e shpenzimeve të përfaqësimit në shumë prej 208.00 euro.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së parë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 21,645.00 euro, ishte refuzuar si e pavlefshme me arsyetimin se afati kohor kur paditësi kishte parashtruar kërkesën e tij për realizimin e së drejtës së tij të pretenduar, e njëjta ishte parashkruar.

Paditësi në shkallë të parë kishte bashkëngjitur këto prova: kopjen e librezës së punës, njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit të datës 14 janar 2009, listën me llogaritjen e të ardhurave personale për muajin dhjetor 2006 si dhe vendimin e ankimuar të AL-së me nr. PRN129-0083 të datës 15 maj 2014.

Shkalla e parë e DHPGJS, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, kishte nxjerrë Aktgjykim me të cilin i kishte njohur paditësit pjesërisht të drejtën në dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 1,168.00 euro me arsyetimin

se i njëjti kishte dorëzuar prova relevante që dëshmonin se N.SH në fjalë ka detyrim ndaj paditësit shumë e lartcekur.

Kolegji i Apelit në rastin konkret vlerëson se shkalla e parë e DHPGJS-së kishte vepruar drejtë me rastin e marrjes së vendimit, ndërsa konsideron se ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Kjo për faktin se nga Njoftimi i AKP për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit i datës 14 janar 2009, i cili është i bashkëngjitur në prova në shkresa të lëndës, shihet që paditësit i është ndërprerë parashkrimi i kërkesës, kur kishte filluar privatizimi i ndërmarrjes në fjalë, pra në datën e lartcekur. Ky njoftim në përmbajtjen e tij theksonte se *“shumat-pagat që u janë borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit me punëdhënësin, do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit dhe se kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura”*. Andaj, paditësi duke vepruar konform njoftimit të lartcekur kishte dorëzuar kërkesën e tij brenda afatit të përcaktuar ligjor në shumë e cekur më lartë.

Gjithashtu nga lista e pagave e muajit dhjetor 2006 shihet se paga e fundit e paditësit ishte 292.00 euro dhe gjykata e shkallës së parë me të drejtë kishte ardhur në përfundim se të njëjtit i takojnë 4 paga të papaguara në emër të dëmshpërblimit për shkak të ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënies së punës në shumë prej 1,168.00 euro (292.00 euro x 4 = 1,168.00 euro).

Sa i përket pretendimeve të së paditurës në ankesën e saj të paraqitur në shkallë të dytë, Kolegji i Apelit vlerëson se e paditura nuk ka paraqitur asnjë argument me të cilin do të dëshmonte të kundërtën e asaj që ka provuar paditësi, pra për të vërtetuar faktin se paditësit nuk i takon dëmshpërblimi i pretenduar apo se të njëjtit nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës me veprim/vendim të AKP-së.

Prandaj, duke u bazuar në këto që u thanë më lart, Kolegji i Apelit konsideron se shkalla e parë ka vepruar drejtë kur paditësit i ka njohur të drejtën në dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 1,168.00 euro.

Nga arsyet e cekura më lartë, ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

**Taksat gjyqësore**

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 30 nëntor 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 17 tetor 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues

\_\_\_\_\_